

Marrëveshje

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

dhe

Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë

për

Bashkëpunim Financiar

2014

për masën shoqëruese të projektit

“Linja unazore 110 kV në Shqipërinë jugore (Përmirësimi i efciencës në fushën e energjisë)”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
dhe
Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë
Republikës dhe Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet
Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 8 maj 2014 –

u morën vesh si vijon:

Neni 1

(1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një shumë financimi me vlefte prej deri në 2.000 000 euro (me fjalë: dy milionë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit “Linja unazore 110 kV në Shqipërinë jugore (Përmirësimi i eficiencës në fushën e energjisë)”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se masat në fjalë vlejnë për t'u mbështetur nga pikëpamja e politikës së zhvillimit.

(2) Po të merren vesh Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

(3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, zbatohet kjo marrëveshje.

(4) Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

(1) Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat ajo vihet në dispozicion si dhe procedura e dhënies së porosisë, përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

(2) Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk përfundohen brenda një afati prej shtatë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron me dt. 31 dhjetor 2021.

(3) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rast se ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më _____ në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë



Për Qeverinë e
Republikës Federale të Gjermanisë

